



ZYRA E BANKES BOTERORE, Tiranë

Thirrje për Projekte në kuadrin e Programit të Granteve të Vogla

Programi i Granteve të Vogla mundëson Bankën Botërore të promovojë dialogun dhe shpërndarjen e informacionit midis organizatave jofitimprurëse. Objektivi i Granteve të Vogla për vitin 2006 përqëndrohet në *rritjen e përgjegjshmërisë sociale përmes angazhimit qytetar*.

Zyra e Bankës Botërore në Tiranë ju fton të paraqisni projekte që:

- **Nxisin një pjesëmarrje më të madhe qytetare dhe diskutim** në nivel kombëtar dhe lokal mbi çështje që lidhen me masat antikorrupsion;
- **Përmirësojnë cilësinë e aktiviteteve sociale për transparencën publike dhe përgjegjshmërinë** në fusha të ndryshme të zhvillimit, duke kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes qytetare;
- **Përmirësojnë transparencën publike dhe përgjegjshmërinë e qeverisë** nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së individëve dhe komuniteteve për informim dhe monitorim të qeverisjes;
- Rrisin përgjegjshmërinë publike për një **akses dhe cilësi të përmirësuar të shërbimeve bazë**;
- **Forcojnë mekanizmat e përgjegjshmërisë** për avokati dhe përfshirje në rritje të qytetarëve dhe shoqërisë civile për të ushtruar presion për përmirësimin e shpërndarjes së shërbimeve publike dhe aktivitetit të strukturave politikë-bërëse;
- **Bëjnë të dëgjohen shqetësimet e aktorëve primarë dhe sekondarë**, vecanërisht popullsisë së varfër dhe të mënjeluar, dhe ndihmojnë që ky zë të përfshihet në programet dhe politikat vendimmarrëse;
- **Rishikojnë kuadrin ligjor mbi angazhimin qytetar dhe përgjegjshmërinë sociale**. Bëjnë rekomandime për përmirësimin e këtij kuadri ligjor.

Janë të ftuar të aplikojnë në këtë program organizata vendase të shoqërisë civile me një eksperience prej të paktën dy vjetësh. Shuma e financuar do të jetë midis 3000\$ dhe 6000\$. Të interesuarit mund të paraqiten për të tërhequr format e aplikimit dhe informacione të tjera mbi kriteret e aplikimit pranë Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë. Ky informacion është vendosur edhe në faqen e internetit: www.worldbank.org.al.

Forma e aplikimit dhe dokumentat e tjera të nevojshme duhet të dorëzohen në një zarf pranë Zyrës së Bankës Botërore në adresë të Koordinatorit të Programit të Granteve të Vogla jo më vonë se 28 Shkurt 2006.

Adresa:

Koordinatori i Programit të Granteve të Vogla

Banka Botërore

Rruga “Dëshmorët e 4 shkurtit”, Nr. 34

Tel: 04 280 560/61

Fax: 042 405 90

Tiranë